

PROCES-VERBAL

Dëgjuesë Publike: Njësia Administrative Xibër

Datë 28.10.2020, Ora 13.00

Marrin pjesë Kryetari i Bashkisë, Nënkryetarja e Bashkisë, Drejtori i Shërbimeve dhe Ifrastukturës, Përgjegjësja e Sektorit të Financës , Administratori Njesisë Administrative Xibër, Përgjegjësja e Zyrës së Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve.

Hap mbledhjen Kryetari i Bashkisë Z.Ilmi Hoxha

Falenderon pjesëmarrësit dhe prezanton stafin që e shoqëron. Qëllimi i takimit është për të diskutuar rreth projekt-buxhetit dhe paketës fiskale të vitit 2021. Paketa fiskale mund të ketë nevojë për ndryshime. Fatkeqësisht jemi një nga Bashkitë që jemi prekur nga tërmeti. Kemi harxhuar kohë dhe burime njerëzore gjatë kësaj kohe. Gjithashtu kemi harxhuar kohë për masat që janë marrë në lidhje me pandeminë. Deri me datë 23.06.2020 ka qene e bllokuar puna me thesarin për shkak të pandemisë. Falë bashkëpunimit me Kryetarët e fshatrave kemi zgjidhur problem në lidhje me ujin vaditës duke bërë të mundur rregullimin e sifonit.

Flet për pakot ushqimore që janë shpërdatë gjatë periudhës së pandemisë dhe që kanë qenë falë kontributit të qytetarëve dhe të bizneseve. Flet për rregullimet që janë kryer nëpër kanalet vaditëse të zonës. Tregon që gjatë vitit 2020 është bërë projekti për Gurrat e Gurit të Bardhë. Thotë që firma e ndërtimit të rrugës së Arbrit duhet të përgjigjet në lidhje me të gjitha dëmët që ka shkaktuar. Tregon që kemi marrë investime nga Bashkimi Evropian në lidhje me ndërtimin e Muzeut.

Sot jemi për të marrë kërkesat tuaja kryesore që ti projektojmë për vitin 2021 dhe ti realizojmë ato.

Merr fjalën Dull Muça

Falenderon Kryetarin për të gjithë punët që ka realizuar. Kërkon zgjidhje për ujin vaditës, për kanalin ng afshati Guri i Bardhë në Fshatin Shkallë.

Kryetari u jep fjalën që do sjellë ujin dhe i falenderon për bashkëpunimin.

Flet Sali Muça (f.Ketë)

Falenderon të gjithë pjesëmarrësit.

Paraqit problemet e kanalit vaditës në fshatin e tij në pjesën e veprës së marrjes dhe të rrugës.

Kryetari shprehet që do të cojë mjetet për rregullimin e rrugës.

Merr fjalën Atnand Mema (Xibër Murrizë)

Falenderon Kryetarin për pjesëmarrjen dhe për kontaktet e herëpashershme me të në lidhje me problemet e ndryshme.

Falenderon për mbështetjen që është dhënë në lidhje me ndërtimin e një shtëpie që është djegur, dhe për rregullimin e kanalit vaditës. Kërkon zhvendosjen e sifonit të kanalit vaditës 70-80 m.

Kërkon ndërhyrje dhe në rrugën kryesore të fshatit.

Flet Kryetari në lidhje me problemet që ka me firmen që po ndërton rrugën e Arbrit në lidhje me hyrjet dhe nënkallimet. Thotë që lagjia Hoxhaj, Stafa janë të bllokuara. Firma edhe pse ka shkaktuar dëme nuk është përgjigjur. Trgon që i ka bërë shkresë ARRSH në lidhje me këtë problem.

Flet Atnand Mema në lidhje me regjistrimin e tokave.

Kryetari sqaro që është ligji 20/2020 që është avantazh për këtë gjë.

Flet Riza Demiri:

Tregon problemet në lidhje me rrugën e Telumit.

Halil Sadiku flet për disa mungesa që janë në shkollë.

Kryetari e falenderon dhe jep zgjidhen për këtë problem.

Merr fjalën Resul Baleta (Guri i Bardhë)

Falenderon për pjesëmarrjen dhe ndërhyrjet që janë bërë në rrugë.

Gjithashtu flet edhe për varrezat që duhen rrethuar.

Merr fjalën Afrim Krosi (F.Bel)

Ashtu si dhe në fshatrat e tjerë edhe në Bel ka shqetësime në lidhje me rrugën, ujin e pijshëm dhe kanalin vaditës.

Bajram Mjeshtri (Dars)

Flet për shqetësimet e banorëve të fshatit të tij në lidhje me ujin e pijshëm, ujin vaditës dhe në lidhje me rrugët.

Problem kryesor mbetet edhe çështja e mbeturinave.

Haki Çira (F.Fullqet)

Në Fullqet problem kryesor është vaditja. Sifoni që është nxjerrë poshtë te ura e Fullqetit u shërben vetëm 6 famileve. Pjesa tjetër ka nevojë për tu hap kanali te rruga te lagjia Dushk. Problem është dhe uji i pijshëm.

Flet Avni Keta i cili për qytetin e Klosit shpreh shqetësime në lidhje me tregun, zgjerimin e Urës së Allamanit dhe vendin për pazarin e gjësë së gjallë.

Para mbylljes së takimit Kryetari pyet të pranishmit nëse janë dakort që ta mbajmë sportin. Ai thotë që të ngresh sportin është vlerë, por problem qëndron se Bashkia Klos nuk ka as fushë as trajnerë dhe pak futbollistë.

Por të pranishmit shprehën dëshirën që sporti të mbahet si një vlerë e shtuar për Klosin.

Kryetari mbyll takimin duke falenderuar pjesëmarrësit për ato cka paraqitën në takim dhe kërkon bashkëpunim.

Përgjegjëse e Sektorit të Financës

Silvana Bala

